



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 112/2018

Datë: 23 shkurt 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.7, të Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe në bazë të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Rregullores nr.03/2016 për Transferim dhe Avancim të prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 23 shkurt 2018, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Burim Çerkini, prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, transferohet në mënyrë të përhershme në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj.
- II. Transferimi i paraparë në pikën I të këtij vendimi do të bëhet nga data 01 mars 2018.
- III. Obligohet Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Shukri Jashari, ka bërë kërkesë për transferim të prokurorit Burim Çerkini nga Departamenti për të Mitur në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj. Në kërkesë kryeprokurori Jashari ka sqaruar situatën në këtë prokurori ku në Departamentin e Krimeve të Rënda ka mungesë të prokurorëve.

Kërkesën e Kryeprokurorit Jashari e ka trajtuar Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit i cili ka njoftuar se prokurori Burim Çerkini është dekretuar më datë 22 dhjetor 2010, ndërsa me vendimin e Këshilli të datës 01 nëntor 2013 është transferuar në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.

Në pajtim me Rregulloren për prokurorin Burim Çerkini janë mbledhur këto informata: Vlerësimi i prokurorit nga Komisioni për vlerësimin e performancës me notë shumë mirë, Komisioni Disiplinor ka raportuar se ndaj prokurorit nuk ka pasur asnjë raport të inicuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, dhe nuk ka të shqiptuar asnjë masë disiplinore, vlerësimet vjetore pozitive nga Kryeprokurori i PTH Ferizaj.

Andaj, pasi që prokurori Çerkini i plotëson kushtet e parapara për transferim, me qëllim të sigurimit të funksionalitetit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, konkretisht Departamentit për Krime të Rënda të kësaj prokurorie, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Blerim Isufaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Ti dërgohet:

- Z. Burim Çerkini;
- Kryeprokurorit të PTH Ferizaj;
- Sekretariatit dhe NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.